



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.581/15

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Shpresa Veselaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Florent Muçaj nga Prishtina, rr. "Agim Ramadani"- Fakulteti Juridik në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me prokurë Labinot Vata avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Organizata jo qeveritare "Lëvizja FOL", me seli në Prishtinë, me Drejtoreshë Mexhide Demolli- Nimani nga Prishtina, rr. "Andrea Gropa" nr.35 në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me prokurë Admir Salihu avokat nga Ferizaj, për dëmshpërblim për shkak të shpifjes dhe fyerjes, pas shqyrtimit kryesor- publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datën 21.07.2026 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I- HEDHET si e pasafatshme padia/kërkesa e paditësit Florent Muçaj nga Prishtina, e paraqitur me dt. 04.09.2019 me të cilën ka kërkuar që e paditura Organizata jo qeveritare "Lëvizja Fol" t'i tërheq deklaratat si të pavërteta për shpifje dhe fyerje, të dhëna me dt. 05.03.2015 në emisionin "Jeta në Kosovë" të transmetuar në RTK me dt. 05.03.2015 duke e quajtur paditësin bandit dhe pjesë të bandës.

II- REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Florent Muçaj nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Organizata jo qeveritare "Lëvizja FOL", me seli në Prishtinë, që brenda 7 ditësh të publikoj një deklaratë publike ku e njëjta duhet të tërheq si të pa vërtetë deklaratat shpifëse dhe fyese të dt. 22.12.2014 dhe 05.03.2015 dhe t'i kërkoj falje paditësit për shpifjet dhe fyerjet e bëra, si dhe që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit jomaterial të shkaktuar nga cenimi i nderit, reputacionit dhe dinjitetit t'ia paguaj paditësit shumën prej 9,500.00 €, me kamatë prej 8% nga paraqitja e padisë.

III- DETYROHET paditësi t'i paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 1,289.60 € në afat prej 15 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Florent Muçaj nga Prishtina në këtë gjykatë ka paraqitur padi me dt. 11.03.2015, kundër të paditurve: 1. Organizata jo qeveritare "Lëvizja FOL", me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me prokurë Admir Salihu avokat nga Ferizaj, dhe 2. Fidan Kalaja- Menaxher i programeve- Zëvendës drejtor i "Lëvizjes Fol" në Prishtinë, për dëmshpërblim për shkak të shpifjes dhe fyerjes në edicionin e lajmeve qendrore të orës 20:00 të transmetuar në Klan Kosova me dt. 22.12.2014.

Me Parashtresën e dorëzuar në gjykatë me dt. 04.09.2019, paditësi ka bërë zgjerimin e padisë në kuptimin subjektiv edhe ndaj të paditurit 3. Petrit Zogaj- ish Drejtor i "Lëvizjes Fol", si dhe

zgjerimin në kuptimin objektiv duke e bërë smadhimin e kërkesëpadisë duke shtuar edhe kërkesën tjetër për shpifje dhe fyerje, e transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës RTK në emisionin “Jeta në Kosovë” me dt. 05.03.2015.

Me aktvendimin C.nr.581/15 e dt. 15.01.2026 Gjykata e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit Florent Muçaj nga Prishtina, në këtë çështje juridike kontestimore, ndaj të paditurve: Fidan Kalaja rr. “Jakup Ferri” nr. 20, tani me adresë të panjohur dhe Petrit Zogaj nga fshati Turjake, Komuna e Malishevës, tani me adresë të panjohur, për shkak të mos deponimit të garancionit nga ana e paditësit, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit e theksuar. Aktvendim e theksuar C.nr.581/15 i dt. 15.01.2026 me këshillë juridike paditësi e ka pranuar me dt. 20.01.2026.

Më tutje Gjykata shqyrtimin në këtë çështje juridike e ka vazhduar sipas padisë së paditësit vetëm, ndaj të paditurës Organizata jo qeveritare “Lëvizja FOL”, me seli në Prishtinë.

Përfaqësuesi i Paditësit si në padi, në parashtresën për rregullimin e padisë dhe në fjalën përfundimtare mbeti në tërësi pranë kërkesëpadisë, duke pretenduar se e paditura ne Organizata e shoqërisë Civile “Lëvizja Fol” e ka kundërshtuar emërimin e paditësit në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) me dt. 22.12.2014 në edicionin e lajmeve qendrore të orës 20:00 të transmetuar në Televizionin “Klan Kosova” me deklaratimet e të paditurës “pas zgjedhjes së anëtarit kinse të shoqërisë civile”, dhe më tutje “ky person i cili pretendon se është anëtar i shoqërisë civile në këtë këshill është, ka qenë përfaqësues i partisë politike”, dhe se me këto deklaratime kanë shkaktuar shpifje dhe fyerje ndaj paditësit dhe kanë shpërndarë informacion të pa vërtetë. Prandaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura “Lëvizja Fol” që brenda 7 ditësh të publikoj një deklaratë publike ku e njëjta duhet të tërheq si të pa vërtetë deklaratat shpifëse dhe fyese të bëra me datën 22.12.2014 dhe 05.03.2015, dhe ti kërkoj falje paditësit për shpifjet dhe fyerja e bëra, të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit jomaterial të shkaktuar nga cenimi i nderit, reputacionit dhe dinjitetit, t’ia paguaj paditësit shumën prej 9,500.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë, në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Me propozim për gjykatën që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar: për përfaqësim në seanca gjyqësore 2x135.00 € dhe 3x 270.00 €, e në shumë të përgjithshme prej 1,080.00 €.

Përfaqësuesi i të paditurës “Lëvizja Fol”, mbeti në tërësi pranë përgjigjes në padi, pretendimeve dhe deklaratimeve të theksuara në seancat gjyqësore, duke e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtura se duke pa parasysh edhe faktin se paditësi është tërhequr nga padia ndaj personave fizik Fidan Kalaja dhe Petrit Zogaj, prandaj në raport me “Lëvizjen Fol” kësaj padie i mungon baza faktike dhe juridike për përgjegjëse civile të paditurës Lëvizja Fol, për shkak se deklaratat mbi të cilat mbështetet padia ndaj Lëvizjes Fol janë

pjesë e intervistave të personave fizik ndaj të cilëve paditësi është tërhequr. Më tej ka sqaruar se deklarata e Lëvizjes Fol ka qenë pjesë integrale e Organizatave të shoqërisë civile, ndërkohë individët Fidan Kalaja dhe Petrit Zogaj në cilësinë e drejtorit dhe menaxherit të programit të Lëvizjes Fol, janë marrë në intervistë dhe në emision si përzgjedhje e pavarur e mediumit, ashtu që Fidan Kalaja në KTV ndërkohë Petrit Zogaj në emisionin “Jeta në Kosovë”, dhe çfarëdo deklarate që ata kanë dhënë aty, e për të cilët paditësi është tërhequr nga padia, prandaj për të njëjtat nuk mund t’i atribuohet përgjegjësia tek ‘Lëvizja Fol’. Duke theksuar se deklarimi i Fidan Kalaja me dt. 22.12.2014 fare nuk përmban shpifje dhe fyerje. Ndërkaq sa i përket deklarimit të Petrit Zogaj të dhënë me datën 05.03.2015 i cili është përfshirë pas precizimit të kërkesëpadisë me parashtresën e dt. 04.09.2019, e njëjta padi konsiderohet e pasafatshme sepse është paraqitur pas afatit 3 mujor të paraparë me Ligjin kundërt fyerjes dhe shpifjes. Prandaj duke qenë se e paditura nuk ka vepruar për t’ia cenuar nderin paditësit, për arsye se deklarata e Lëvizjes Fol nuk përmban as shpifje e as fyerje, ndaj dhe rrjedhimisht nuk i takon as kompensimi i pretenduar për cenimin e nderit dhe reputacionit. Me propozim për gjykatën që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar: për përgjigje në padi 208.00€, për përfaqësim në seanca 4x270.40€, e në shumë të përgjithshme prej 1,289.60€.

Gjykata për të vërtetuar bazueshmërinë e padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe gjendjen e plotë të fakteve, e për të vendosur drejtë në këtë çështje juridike kontestimore, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me dt. 21.07.2026, në procedurën e provave bëri administrimin e provave dhe atë:

Letër nominimi i OMNES i datës 07.07.2014 me të cilin Florent Muçaj propozohet për anëtar joprokuror në Këshillin Prokurorial të Kosovës; Vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës me nr. 1035/2014 i datës 15.09.2014 me të cilin Florent Muçaj emërohet anëtar joprokuror i Këshillit Prokurorial; Kopja nga webfaqja e Lëvizjes Fol sipas të cilës Petrit Zogaj është Drejtor Ekzekutiv në “Lëvizjen Fol”, ndërsa Fidan Kalaja është Menaxher i programeve; Shkrime të gazetave: qëndrime të ngjashme të OJQ-së deputetit dhe kryeministrit të datës 01.04.2013 dhe gazeta Ekonomia: Organizata e shoqërisë civile distancohen nga Florent Muçaj e datës 06.03.2014 dhe shkrimi Njeriu i OJQ-së së Arsim Bajramit në Këshillin Prokurorial i datës 09.09.2014; Kërkesa e paditësit drejtuar “Lëvizjes Fol” e datës 09.03.2015; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1992/15 i datës 12.03.2021 me të cilin është aprovuar kërkesa e paditësit dhe është obliguar KPK që t’ia kompensoj në mënyrë retroaktive pagesën si anëtar i KPK-se dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës me nr. AA.nr.413/21 i datës 27.09.2022 me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e Këshillit Prokurorial të Kosovës; si dhe Transkripti i Emisionit të Lajmeve të datës 22.12.2014 në Klan Kosova dhe në emisionin Jeta në Kosovë të datës 05.03.2015 në RTK; E-maili nga Rrjeti Ballkanik për gazetari hulumtuese dërguar anëtarëve të Këshillit Prokurorial Sylë Hoxha etj. kërkesë për fillimin e hetimeve ndaj anëtarit të KPK-se Florent Muçaj i datës 06.03.2015.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara një nga një dhe të gjitha së bashku me kujdes, ndërgjegjeje sipas dispozitës së nenit 8 të LPK- së, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Nuk është kontestuese se me Letër nominimi i OMNES i datës 07.07.2014 këtu paditësi Florent Muçaj ishte propozuar për anëtar joprokuror në Këshillin Prokurorial të Kosovës; dhe me Vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës me nr. 1035/2014 i datës 15.09.2014 Florent Muçaj është emëruar anëtar joprokuror i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK-së).

Nuk është kontestuese se paditësi ka realizuar kërkesën e tij sipas Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1992/15 i datës 12.03.2021 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës me nr. AA.nr.413/21 i datës 27.09.2022.

Kontestuese me palëve ndërgjyqëse në këtë çështje juridike ishte nëse e paditura Organizata jo qeveritare “Lëvizja Fol” me dt. 22.12.2014 në deklamimet në edicionin e lajmeve qendrore të orës 20:00 të transmetuar në “Klan Kosova” në kronikën mbi zgjedhjen e përfaqësuesit të shoqërisë civile në KPK, paraqesin shpifje dhe fyerje ndaj paditësit.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit ndaj të paditurit Organizata jo qeveritare “Lëvizja FOL”, me seli në Prishtinë, është në tërësi e pabazuar. Kjo pikërisht për arsye se mbi bazën e provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara lidhur me pretendimin e paditësit se Organizata e Shoqërisë civile “Lëvizja Fol” me dt. 22.12.2014 në edicionin e lajmeve qendrore të orës 20:00 të transmetuar në “Klan Kosova” në kronikën mbi zgjedhjen e përfaqësuesit të shoqërisë civile është deklaruar se pas zgjedhjes së anëtarit kinse të shoqërisë civile tash politika përfaqësohet me 2 anëtarë, ky person i cili pretendon se është anëtar i Shoqërisë civile në KPK (Këshilli Prokurorial i Kosovës), ka qenë dhe është përfaqësues i partive politike. Gjykata konsideron se në rastin konkret bazuar/ viza-a-vi dispozitës së nenit 8 të Ligjit kundër shpifjes dhe fyerjes, kjo deklaratë bie në domenin e deklaratave faktike, vlerësimeve, opinioneve dhe qëndrimeve editorialë në këndvështrimin se kjo çështje e zgjedhja e anëtarit të KPK-së ka të bëjë me interes publik dhe me paditësin si anëtar i KPK-së me ndikim publik. Mbi këtë bazë gjykata vlerëson se duke e kundëruar këtë çështje në përputhje me praktikën e GJDENJ- së (Rastet Lingens kundër Austrisë etj.) ku sipas kësaj praktike liria e shprehjes mbron edhe deklaratimet që mund të jenë edhe shqetësuese, provokuese dhe kritike. Kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjerë ndaj personave publik, siç mund të jetë edhe rasti i paditësit kur është zgjedhur anëtar i KPK-së. Ndërkaq çështja në fjalë e referuar, siç është theksuar në dispozitiv në paragrafin 2 të këtij aktgjykimi, e cila është refuzuar, pikërisht për arsye se mediat, e madje edhe e paditura në kuadër të Shoqërisë civile- përkatësisht “Lëvizja Fol”, gëzon një shkallë të lartë mbrojtjeje kur veprojnë në kuadër të debatit publik siç mund të jetë edhe rasti konkret.

Pikërisht për këto shkaqe dhe arsye duke marre para sysh standardet e vendosura nga GJEDNJ, kërkesëpadia e paditësit është refuzuar në tërësi si e pabazuar si në paragrafin II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të gjykatës ishin edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike.

Ndërkaq gjykata e hedhi si të pasafatshme padinë e paditësit si në paragrafin I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sa i përket kërkesës së paraqitur me Parashtresën e dt. 04.09.2019 me të cilën ka kërkuar që e paditura "Lëvizja Fol" t'i tërheq deklaratat si të pavërteta për shpifje dhe fyerje të dhëna me dt. 05.03.2015 në emisioni "Jeta në Kosovë" të transmetuar në RTK, duke e quajtur paditësin bandit dhe pjesë të bandës. Kjo pikërisht për arsye se paditësi padinë e ka paraqitur pas afatit, sipas dispozitës së nenit 17 par.1 të Ligjit kundër shpifjes dhe fyerjes, ku sipas dispozitës së theksuar është parashikuar që afati për paraqitjen e padisë është 3 muaj nga momenti kur paditësi ka marrë dijeni. Prandaj duke qenë se padia- kërkesa e paditësit për këtë pjesë është paraqitur në gjykatë me dt. 04.09.2019 lidhur me pretendimin për shpifje dhe fyerje të dt. datës 05.03.2015, ndaj gjykata konstatoi se kërkesa është e paraqitur pas afatit ligjor sipas dispozitës së theksuar të Ligjit kundër shpifjes dhe fyerjes.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata vendosi sipas dispozitës së nenit 449 dhe 452 par.1 të LPK-së, e të cilat i referohen shpenzimeve: për përgjigje në padi 208.00€, për përfaqësim në seanca gjyqësore 4x 270.40 €, e në shumë të përgjithshme prej 1,289.60 €.

Për këto shkaqe dhe arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i përgjithshëm
C.nr.581/15, dt. 21.07.2026

Gjyqtarja:
Shpresa Veselaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.

